

Analizoni buxhetin e Kosovës përmes shkrimeve të bazuara në të dhëna

Garë e hapur për shkrimin më të mirë në analizimin e të dhënave buxhetore

Instituti GAP hap garën me shkrime analitike për studentët e nivelit baçelor dhe master në Kosovë për vitin e dytë me radhë. Kjo garë synon:

- Shfrytëzimin e energjisë, kreativitetit dhe ideve të rinjve për promovimin e një kulture të qytetarisë aktive
- Përmirësimin apo përvetësimin e aftësive kërkimore mbi çështjet buxhetore
- Frymëzimin e rinisë për të ndërmarrë iniciativa për ndryshim

Tema e përgjithshme: "Të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit të Kosovës"

Tema potenciale: "Sa është e rëndësishme përfshirja e qytetarëve në vendosjen e prioriteteve buxhetore?"; "Cilat investime janë më frytdhënëse?"; "Në cilën fushë duhet të prioritizohen investimet?"; "Sa investohet në infrastrukturë shkollore e sa në programet dhe cilësinë e arsimit?"; "Cilat fusha subvencionohen më së shumti e sa ndikojnë këto subvencione në zhvillim profesional apo rritje të produktivitetit?"; "Trendet e të hyrave"; "Analiza e buxhetit të komunës sime", e të tjera.

Publikime për buxhetin e Kosovës mund të gjeni në faqen e Institutit GAP (www.institutigap.org/publikime), ndërsa shkrime të shkurtëra gjeni në GAP Monitor (www.institutigap.org/monitor).

*Inkurajoheni të krijoni temën dhe argumentet tuaja nga çështjet që iu preokupojnë më së shumti, ndërsa çështjet e mësipërme t'i merrni vetëm si inspirim.

Udhëzimet për aplikim:

- Autorët e shkrimeve duhet të jenë studentë të nivelit baçelor ose master.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të pabotuara. Shkrimet e plagjiarizuara do të refuzohen.
- Shkrimet duhet të shkruhen nga një apo dy autorë. Shkrimet e shkruara nga më shumë se dy bashkë-autorë nuk do të pranohen.
- Shkrimet duhet të jenë deri në 1,000 fjalë. Shkrimet më të gjata do të diskualifikohen automatikisht.
- Burimet e të dhënave duhet të citohen brenda tekstit/me fusnotë. Nuk ka nevojë për listë referencash.
- Në shkrim duhet të iu referoheni qartë të dhënave nëse ato janë: shpenzime aktuale (nga raportet financiare) apo të planifikuara (nga Ligji për buxhetin).
- Burimet potenciale të të dhënave:
 - Ministria e Financave (MF): mf.rks-gov.net
 - Zyra Kombëtare e Auditimit: www.zka-rks.org
 - Faqet zyrtare të komunave të Kosovës
 - Platforma buxhetore e Institutit GAP: www.institutigap.org/buxheti
- Shkrimet duhet të dërgohen në format Word MS, font Times New Roman, në madhësi 12 dhe me hapësirë 1.5 në emailin info@institutigap.org. Po ashtu, duhet të bashkangjiteni kopjen e skanuar të kartelës studentore apo ndonjë dëshmi tjetër që tregon se jeni studentë në kohën e dorëzimit të shkrimeve.
- Në titullin e emailit (Subject) shkruani Gara me Shkrime, Emri dhe Mbiemri.
- Afati i fundit për dorëzim të shkrimeve është më 15 nëntor 2019 në mesnatë.

Shkrimet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të merren parasysh.

Formati i Shkrimeve:

● Hyrje

- Paragrafi hyrës duhet të përfshijë tezën apo qëllimin e shkrimit, duke i njoftuar lexuesit rreth temës kryesore të tij. Nuk duhet përdorur të dhëna ose fakte thelbësore që mbështesin argumentet tuaja në këtë seksion.

● Përmbajtja

- Vendosni të gjitha të dhënat dhe faktet këtu. Organizoni idetë në sa më shumë paragrafë të nevojshëm që mbështesin tezën apo qëllimin e shkrimit tuaj. Nëse keni tri argumente, shkruani ato në tre paragrafë duke i radhitur sipas rëndësisë dhe potencialit për t'i mbështetur ato.

● Përfundimi

- Mos vendosi informacione apo të dhëna të reja në këtë paragraf. Vetëm përmbledhni mirë shkrimin duke ripërmendur argumentet kryesore të tij dhe duke sinjalizuar fundin e tij apo duke bërë një "thirrje për veprim" nëse shkrimi juaj do të shkruhet në atë mënyrë që të bind lexuesit të veprojnë kundrejt diçkaje.

Vlerësimi i Shkrimeve:

Instituti GAP do të përzgjedhë një panel vlerësues nga tre analistë dhe hulumtues brenda Institutit si dhe një profesor/eshë të Ekonomisë/Ekonomiksit.

Paneli vlerësojnë në mënyrë të pavarur të gjithë finalistët në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- Originaliteti në temat e trajtuara
- Përdorimi i të dhënave në mënyrë të drejtë/ Saktësia e të dhënave
- Cilësia dhe thellësia e hulumtimit
- Stili i shkrimit, gramatika, drejtshkrimi, pikësimi dhe citimi

Çdo anëtar/e i/e panelit vlerësues do të lexojë dhe vlerësojë përmbajtjen e përgjithshme dhe thelbin e shkrimit dhe pastaj do të notojë me pikë tri shkrimet më të mira nga i tërë grumbulli. Nëse secili/a anëtar/e vlerëson shkrime të ndryshme, atëherë ato maksimum 12 shkrime potenciale (tri nga çdo anëtar/e) do të rivlerësohen në grup për të përcaktuar fituesit përfundimtarë.

Vetëm fituesit e tri vendeve të para do të lajmërohen.

Çmimet:

- +1** 150 euro dhe mirënjohje
- 2** 120 euro dhe mirënjohje
- 3** 100 euro dhe mirënjohje

Dërgoni shkrimet tuaja deri më **15 nëntor 2019**

